



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 495 /2025

Në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-40 neni 43, nenit 31 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, bëjë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e parë -I- të rregullt për vitin 2025 të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet me datë 30.01.2025 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për vitin 2024.
3. Plani i punës së këshillave të fshatrave për vitin 2025.
4. Raporti i planit lokal të veprimit për barazi gjinore për vitin 2024.
5. Raporti i mekanizmit kundër dhunës në familje në Han të Elezit.
6. Raporti i ekipit komunal për të drejtat e fëmijëve në Han të Elezit.
7. Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2024.
8. Të ndryshme.

Bashkë me ftesën ju dërgojmë:-

- Procesverbalin nga mbledhja e kaluar.
- Materialin e raportit financiar për vitin 2024.
- Materialin e planit të punës së këshillave të fshatrave për vitin 2025.
- Materialin e raportit të planit lokal të veprimit për barazi gjinore për vitin 2024.
- Materialin e raportit të mekanizmit kundër dhunës në familje në Han të Elezit.
- Materialin e raportit të ekipit komunal për të drejtat e fëmijëve në Han të Elezit.
- Materialin e informatës mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2024.

Hani i Elezit
Data:-21.01.2025

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 496/2025
Data: 21.01.2025

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e dymbëdhjetë -XII- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 30.12.2024 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **KimeteKuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2025.
3. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2025.
4. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2025.
5. Draft rregullorja komunale për menaxhimin të pasurisë jo financiare komuna Hani i Elezit.
6. Raporti mbi planin e integritetit për vitin 2024.
7. Propozim vendim për ndërtesat e vjetra kolektive të cilat janë në zonën urbane.
8. Propozim vendim për listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës për vitin 2025 të cilat parashihen të jepen për shfrytëzim.
9. Rishqyrtimi i aktit normativ rregullorja për taksa komunale për vitin 2025.
10. Rishqyrtimi i ligjshmërisë së aktit për z.Endrit Curri për ndërrim-destinimin e pronës.
11. Rishqyrtimi i ligjshmërisë së aktit për z.Faton Curri për ndërrim-destinimin e pronës.
12. Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi
13. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:-para vetës e keni planin e punës për vitin 2025 sipas objektivave që e kemi paraparë që të zhvillohen në vitin 2025. Si prioritet kemi shërbimet ndaj qytetarëve, ngritja e shërbimeve shëndetësore dhe të mirëqenies sociale, rregullimi i infrastrukturës urbanistike , arsimit,familja dhe siguria, zhvillimi ekonomik. Në bazë të këtyre prioritetëve pastaj dalin objektivat,stimulim i nxënësve për regjistrim në shkollat profesionale me mbulim të shpenzimeve të udhëtimit dhe studentëve të suksesshëm me bursa studentore, Trajtimi i barabartë në ofrimin e shërbimeve sociale dhe skemës sociale, Menaxhim cilësor dhe efektiv të buxhetit të komunës për vitin 2025, Vazhdim i bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe lokale, Transparencë digjitale për të gjitha aktivitetet në komunë dhe shpenzimet buxhetore, Krijimi i kushteve optimale për punë në çerdhen e fëmijëve, Vazhdim i përkrahjes së institucioneve dhe aktiviteteve kulturore dhe sportive, Vazhdim i rritjes së shërbimeve në QKMF dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për qytetarët, Realizimi cilësor i të gjitha projekteve të planifikuara, Miratimi i PZHK-së dhe harta zonale e komunës, Informimi i qytetarëve dhe përkrahja për legalizimin e ndërtimeve pa leje sipas ligjit për legalizime, Inkurajimi dhe mbështetja e qytetarëve për zhvillimin e aktiviteteve biznesore dhe përkrahja për hapje të bizneseve të reja, Vazhdimi i përkrahjes dhe stimulimi i fermerëve përmes subvencioneve, Bashkëpunim me komuna të ndryshme duke përfutur nga eksperiencia e tyre dhe shembujt pozitiv, Bashkëpunimi ndër komunal dhe ndërkufitar me komuna, Bashkëpunim me institucione shtetërore, OJQ dhe institucione ndërkombëtare për prezantimin dhe afirmimin të komunës tonë, Digjitalizimi i Bibliotekës së qytetit të Hanit të Elezit.

Sherif Berishat thekson:- sikur plani i punës për vitet e më hershme të punës edhe ky plan i punës për vitin 2025 është i njëjtë dhe nuk përfshinë ndonjë projekt të veçantë apo objektiva të rëndësishme që projekti të ndikojë te qytetarët. Të gjitha planifikimet për vitin 2025 do të mbesin në letër sikur kanë mbetur edhe nga vitet e kaluara me qenë se në asnjë vit nuk kemi pasur punë konkrete të rëndësishme. Në të gjitha drejtoritë shifrat janë të njëjta dhe asgjë specifike për vitin 2025.

Nora Xhoni thekson:- i dëgjova objektivat dhe ndër prioritet që i shpalose u potencua stimulimi i nxënësve për regjistrim nëpër shkollat profesionale por kërkoj sqarim më konkret në këtë çështje nga drejtorja e arsimit.

Refet Kalisi thekson:- edhe vitet e kaluara është potencuar shtrimi me kupëza betoni nëpër fshatra por është mirë me u përcaktuar rrugët pra të definohet se cila rrugë. Edhe te muret mbrojtëse dhe kanalizimet duhet të shënohet.

Mehmet Ballazhi thekson:- është plan të cilin ne mundohemi me i realizuar projektet të cilat janë brenda planit dhe në Han të Elezit projektet janë të njëjta dhe nuk kemi çka dallojmë përveç prioritetëve që i potencuam.

Hisni Luri thekson:- çështjen e subvencionimit të mësimi deficitarë e kemi duke filluar prej bursave për studentë që nga katërdhjetë është ngritur numri në pesëdhjetë. Ne vazhdojmë me i mbështetur nxënësit të cilët janë në shkollat në Kaçanik në drejtimet profesionale, ndërsa për Ferizaj e kemi diskutuar me të gjitha kompanitë të cilët kanë potencuar se njëri mos me u pajtuar kemi me u kthyer në pikën zero për shkak se me një kompani kemi bërë kërkesë që së paku gjysë për gjysë të jetë çmimi në raport me udhëtarët e zakonshëm, që ne të ju krijojmë bexha nxënësve të cilët udhëtojnë, mirëpo ka qenë e pamundur për shkak se nuk është që funksionon vetëm një kompani. Për me bërë një relacion direkt Hani i Elezit, Kaçanik, Ferizaj është problem me mor licencën e linjës së transportit. Kemi filluar një bashkëpunimi me akademinë Flutura që do të ketë drejtime profesionale të cilat do të zhvillohen këtu , pra do të jetë mundësia më e mirë për nxënësit.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAPLANI I PUNËS SË EKEZEKUTIVIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2025

1. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- janë paraparë temat në kohë të caktuar se kur do të diskutohen. Nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson:- është plan i njëjtë nuk ka ndryshime dhe nuk kemi pasur raporte të detajuara se çka ka pasur probleme në komunën tonë.

Refet Kalisi thekson:-a keni ndonjë informacion për çështjen e qenve endacak për shkak se është problem në tërë Kosovën për shkak se çështja e qenve endacak është problem bukur i madh.

Hyriete Isufi thekson:- eliminimi i deponive ilegale së paku dy herë në vit, kërkoj sqarim se çka parashihet.

Mehmet Ballazhi thekson:- është plan i njëjtë por nuk mundesh mos me pasur eliminimin e deponive ilegale, kuptohet nëse krijohen. Pastrimit të ambientit nuk mundemi me i ikur. Vendosija e mbrojtëseve nëpër trotuare pra ku do që do të ketë nevojë kemi me i vendosur mbrojtëset. Riparimi i kapakëve të pusetave pra nëse dëmtohet ndonjë ne duhet me i rregulluar se është rrezik për qytetarë. Kemi diskutuar për çështjen e qenve endacak por nuk ka mundësi me marr masa sa i përket strehimores për shkak të kapaciteteve buxhetore për shkak se është shqetësim i të gjithave komunave.

Kryesuesi thekson:- është mirë që të bashkëpunojmë me të gjithë aktorët dhe me të policisë që mbahen këto takime që kundrejt KEDS-it te merren gjërat më konkretisht, më seriozisht për shkak se shumë administratorë kanë bërë kërkesa me shkrim për ndërrimin e shtyllave elektrike por asnjë herë nuk ka pasur rezultat. Rasti më i freskët është te Lagjja Meliq që edhe kur ka rrymë në komunën tonë ajo si lagje për shkak të ngarkesës që është në sezonën e dimrit nuk ka rrymë, ndërsa KEDS-si po vjen me polici te qytetari kur nuk i bëhet pagesa e pse policia mos me marr masa në këtë drejtim aty ku rrezikohet qytetari. Ndoshta këto çështje janë diskutuar por rezultate konkrete nuk ka pasur, ndërsa banorët po ankohen vazhdimisht në komunë. Drejtuesit e KEDS-it as telefonat nuk po i qelin as nuk japin ndonjë rezultat. Te kufiri rruga që është shtruar me asfalt dhe vijat e bardha të cilat janë vendosur duhet të ndryshohen për shkak se ka rrezik për atë pjesë sepse nëse ndodhë ndonjë aksident faj kujna i mbetet. Zebrat është e nevojshme me u vendosur në drejtim të rrugës që shkon te lagjja e Vlashëve.

Mehmet Ballazhi thekson:- këto çështje i kemi diskutuar por edhe do t'i diskutojmë këtu përfshihet edhe çështja e shtyllave të cilat e rrezikojnë sigurinë dhe për këtë arsye është në plan të punës, mirëpo ju mund të propozoni ndonjë temë për me diskutuar që nuk është përfshirë në plan. Projekti të kufiri ende nuk ka përfunduar dhe në vitin 2025 janë edhe disa punë, mirëpo për çështje të vijave edhe unë kam vërejtje dhe e kam diskutuar me bartësit e atij projekti por arsyetimi i tyre ka qenë se për shkak të qarkullimit nuk kanë mundur me i rregulluar. Çështja e zebrave është kryer.

Sherif Berisha thekson:- në takimet të cilat i keni pasur keni diskutuar për dukuritë negative, për bixhozin, sigurinë në për shkollë që edhe aty po çalon situata. A ka diçka konkrete për këto çështje.

Mehmet Ballazhi thekson:- këtu që u theksuan më lartë janë në plan që do të diskutohen për vitin 2025 por ju nëse keni ndonjë temë që është e rëndësishme dhe që ne nuk e kemi planifikuar mund ta propozoni.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim;rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2025

4.Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hyriete Isufi thekson:- te muaji tetor dhe nëntor pika e ditë e rendit të punës që është paparë për inspektorin e sanitarisë dhe inspektorin e tregut , çka është paparë.

Resul Suma thekson:- për secilën pikë që është paparë përgjegjësit vijën në mbledhje të komitetit dhe raportojnë për punët e tyre të cilat janë duke i kryer. Ka disa drejtorë që edhe pse i kemi ftuar në mbledhja nuk marrin pjesë në mbledhje të komitetit për komunitete.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2025

5. Draft rregullorja komunale për menaxhimin të pasurisë jo financiare komuna Hani i Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- draft rregullorja ka të bëjë me rregullimin dhe përcaktimin për procedurat dhe kriteret për menaxhimin e pasurisë jofinanciare të komunës. Rregullorja do të ju nënshtrohet procedurave të debatit publik dhe pastaj do të procedohet për miratim në kuvendin e komunës. Nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni.

Refet Kalisi thekson:- kërkoj sqarim më të hollësishëm se për çka bëhet fjalë.

Natyra Kalisi thekson:- rregullorja ka të bëjë për dokumentimin, ruajtjen, lëvizjen, tjetërsimin dhe detyrat e regjistrimit të inventarizimit të komunës. Të gjitha asetet që i kemi brenda komunës i ruajmë në sistemin e pasurisë dhe bëhet fjalë si për pasurinë jo financiare nën njëmijë euro , pasurinë jo financiare mbi njëmijë euro, si dhe stoqet.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U APROVUA DRAFT REGULLORJA KOMUNALE PËR MENAXHIMIN E PASURISË JO FINANCIARE KOMUNA HANI I ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR DEBAT PUBLIK

6.Raporti mbi planin e integritetit për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- është obligim ligjorë që ta paraqesim në kuvend këtë raport sepse e kemi edhe në program të performancës që ta paraqesim në kuvend komunal mbi ato të cilat ne i kemi pasur si sfida në ruajtjen e integritetit komunal. Ky planë është si pjesë e angazhimeve tona për promovimin e vlerave si qeverisje e drejtë si dhe përfaqëson një kornizë të rëndësishme për parandalimin e korrupsionit dhe për rritjen e besueshmërisë ndaj qytetarëve drejtë administratës komunale. Materialin keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

7.Propozim vendim për ndërtesat e vjetra kolektive të cilat janë në zonën urbane.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- propozim vendimi ka të bëjë me ndërtesat e vjetra kolektive. Përmes këtij propozim vendim do të ju mundësohet pronarëve të ligjshëm të banesave që ato në marrëveshje mes vete apo me ndonjë investitorët mundë të bëjnë ndërtime të reja gjithmonë duke u bazuar në planin rregullues të komunës në parcelet ekzistuese të cilat evidentohen në librat kadastralë në shfrytëzim të përhershëm. Ndërtimet eventuale të ndërtesave të reja duhet të jenë në pajtim të plotë me planet urbane rregulluese të komunës ligjin mbi ndërtimet dhe rregulloren për taksat komunale. Në material e keni listën e ndërtesave se për cilat ndërtesa bëhet fjalë dhe po ashtu e keni edhe një vlerësim të kompanisë së licencuar për njërën e këtyre banesave e cila tregon qëndrueshmërinë dhe gjendjen ekzistuese të këtyre banesave.

Zaim Bela thekson:-nëse mbetet që pronarët me u dakorduan asnjë herë nuk kanë me arritur me bërë marrëveshje, mirëpo pasi janë prona komunale a kemi drejtë me ligj që me ndërtuar dhe pas ndërtimit prona jetë prapë komunale dhe komuna me marr iniciativë për me u marr vesh pronarët.

Resul Suma thekson:- te puna e arsytimit ligjshmëria është që te njëra e ke shënuar 04L210 te njëra L134 është mirë me na treguar se ligjin L134 e kam lexuar dhe nuk shënon asgjë për banesat e vjetra. Me cilin ligj je bazuar që e ke bërë këtë propozim vendim. Shpresoj që ky vendim mos me u kthyer paraparë nga MAPL-ja por kisha pas qeft që zyrtari ligjorë me ndaj shpjeguar më mirë çështjen e ligjshmërisë.

Sherif Berisha thekson:- është me plan zhvillimorë komunal të riun apo të vjetrin është shumë me rëndësi me na njoftuar.

Nexhmedin Daci thekson:-ndërtesat më herët kanë qenë pronë shtetërore po ashtu edhe parcelat, ju e dini se ato janë shitur në vitin 1991 e këndej, kështu që banesat janë bërë private ndërsa toka në kadastër figuron që është e komunës por defakto nuk ka shanc me qenë e komunës sepse askund në botë nuk ka që toka me qenë e jotja ndërsa shtëpia e imja që do të thotë nuk janë dy sende juridike por është një send juridik. Ligji i tokës ndërtimore është në procedura të miratimit dhe ligji për banim kolektivë që me këto dy ligje do të ju mundësohet pronarëve të këtyre banesave që edhe toka me qenë e tyre pra do të jenë bashkë pronarë të parcelës ku vendoset ndërtesa. Ligji L- 134 shënon që komuna obligohet që pronarët e banesave që ti bënë titullarë të parcelës, pra realisht toka është defakto e tyre . Ju i keni parë ndërtesat e vjetra se në çfarë gjendje janë. E kemi përfunduar planin zhvillimorë të komunës dhe për momentin është në Ministri sepse ne e kemi përcjell dhe na kanë dërguar me dhënë komente dhe i kemi dhënë komentet dhe po presin me najë dhënë pëlqimin për me hapur debatin publik , mirëpo pavarësisht kësaj ne e kemi planin rregullues urbanë dhe planin zhvillimorë komunal ekzistues dhe janë të rregulluara këto çështje.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim;rezultati i votimit ishte 13 për , 1 kundër, 1 abstenim.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR NDËRITESAT E VJETRA KOLEKTIVE TË CILAT JANË NË ZONËN URBANE

8.Propozim vendim për listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës për vitin 2025 të cilat parashihen të jepen për shfrytëzim.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- edhe në vitin 2022 kemi marr vendim por jemi te përsëritë të njëjtën procedurë sepse ndërlidhet me performancën komunale . Janë dy parcele në fshatin Pustenic dy në fshatin Rezhancë dhe një në fshatin Krivenik. Prona tjera të përshtatshme për me i dhënë me qira nuk kemi.

Zaim Bela thekson:- çmimi fillestarë 0.20 m² nëse është për bujqësi për një vit i bien 2000 €, me ligj të bujqësisë ka qenë 50 € për hektarë. Unë propozoj që të jetë 100 € për hektarë për kullosa apo për me mbjellë ndërsa për ndërtim ne të jetë 0.20 €.

Kryesuesi thekson:-propozimin e z. Zaim Bela e hedh në votim, rezultati i votimit ishte njëzëri. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim;rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAMIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR LISTËN E VEÇANTË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS PËR VITIN 2025 TË CILAT PARASHIHEN TË JEPEN PËR SHFRYTËZIM.

9. Rishqyrtimi i aktit normativ rregullorja për taksa komunale për vitin 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- Ministria e Planifikimit Hapësinorë ka dhënë vërejtje te neni katërmbëdhjetë i rregullores për taksa dhe tarifa edhe pse është e kuptueshme por ne e kemi përcjell për rishqyrtim në kuvend për veprimtarit për të cilat kërkohet pëlqim mjedisorë dhe i kemi shënuar të njëjtat shifra sipas udhëzimit.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim;rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RYSHQYRTIMI I AKTIT NORMATIV RREGULLORJA PËR TAKSA KOMUNALE PËR VITIN 225

10. Rishqyrtimi i ligjshmërisë së aktit për z.EndritCurri për ndërrim-destinimin e pronës.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abduraman Bushi thekson:- rishqyrtimin e vendimit e kam bazuar në dy arsye. Arsye parë është se sipas planit zhvillimorë komunal zona ku është kjo parcelë është zonë ndërtimore. Arsye dytë është që edhe në fletë poseduese shënon tokë ndërtimore dhe bujqësore. Kërkoj që të miratohet për shkak se qëndrojnë pranë vendimit të njëjtë dhe ky vendim është i ligjshëm.

Zaim Bela thekson:- qytetarët po kanë nevojë me u zgjeruar në atë vend por nuk e di me plan zhvillimorë të riun a e kemi planifikuar dhe çka ndodhë nëse nuk na e pranon si të ligjshëm nëse ne votojmë në kuvend por nëse qytetari e bënë ndërtim pa leje dhe çka ndodh. Ne duhet të gjejmë mundësi se dikush ndoshta ka mundësi me bërë ndërtim në atë pjesë. Unë jam për me votuar por duhet të jetë në rregull me ligjin.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës dhe pika e cila është pa kësaj Ministria përgjegjëse nuk e ka shikuar kadastrin që me vërtetuar se ajo zonë është zonë e ndërtimit dhe me një far forme e kanë pranuar që e kanë bërë këtë lëshim dhe e kanë diskutuar me zyrtarin ligjorë dhe me drejtorin me të cilin kanë ardhur në përfundim që me përcjell në kuvend. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim;rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RYSHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTIT PËR ENDRIT CURRI PËR NDËRRIM DESTINIM E PRONËS

11. Rishqyrtimi i ligjshmërisë së aktit për z.FatonCurri për ndërrim-destinimin e p ronës.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abduraman Bushi thekson:-është i njëjti rast dhe bëhet fjalë për të njëjtën parcelë.

Kryesuesi thekson:-a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim;rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RYSHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTIT PËR FATON CURRI PËR NDËRRIM DESTINIM E PRONËS

12. Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi.

Abduraman Bushi thekson:-drejtorja e bujqësisë brenda mundësive buxhetore i ka ndihmuar dy sektorë, sektorin e bletarisë që kemi ndarë 2500 pogaçe për ushqim për bletët që kanë qenë përfitues 38 bletarë. Sektorin e lavërtarisë që kemi ndarë 13 pajisje bujqësore.

Sherif Berisha thekson:- në listat përfituese shihen emra të drejtorëve, emra të zyrtarëve që mendoj që është konflikt interesi sepse edhe më herët ka ndodhë dhe ende po vazhdon.

Mehmet Ballazhi thekson:- nëse ka ndonjë konflikt interesi mundeni me kërkuar sqarimin e kësaj por janë subvencionime për fermerë dhe nuk mundemi me diskriminuar në momentin kur nuk mbetet asnjë jashtë, nëse krejt kanë kërkuar dhe janë subvencionuar nuk mundesh me diskriminuar sepse mund ta kesh ty ndonjë familjarë sepse ne jemi Hani i Elezit por të gjithë kanë përfituar dhe nuk ka pasur asnjë lloj ankese.

Kryesuesi thekson:-a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

13. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- kam pranuar një përgjigje dhe nuk jam i kënaqur edhe pse edhe pa e kërkuar e kam se çka ka ndodhur por më është dashur ta dijë se a ka pasur ligjshmëri në atë drejtim, a ka pasur ndonjë vendim për mu paguar për shkak se nëse ka pasur ndonjë vendim dhe ka qenë i ligjshëm është dashur në tjetër mënyrë për me i marr të hollat e jo me përmbarues për shkak se nuk është e hijshme që zyrtari ligjorë me marr të holla me përmbarues. Falënderojë drejtoreshën për shëndetësi për shërbimin që janë tu i bërë në QKMF, falënderojë edhe stafin për shërbimin që kemi pasur sepse deri tash nuk kam vërejtje.

Sherif Berisha thekson:- falënderoj drejtorin e arsimit për shkak të përgjigjisë të cilën na e ka ofruar brenda afateve ligjore. Te drejtoresha e kulturës është një kërkesë të cilën e kemi parashtruar që tri javë e më tepër por nuk ka asnjë përgjigje. Nga sektori i shëndetësisë nga vetë stafi i shëndetësisë thuhet që shëndetësia nuk ka qenë kurr më keq qoftë nga përmbajtja e orarit nga stafi qoftë nga shërbimet. Pse mjeku i kontraktuar nga Islamik Reliefi nuk e veshë uniformën e një mjeku por veshë uniformë tjetër, a bie ndeshë me rregullat e punës.

Kimete Kuka –Hasallari thekson:- sa i përket keq menaxhimit dua ta dijë se çka është keq menaxhim aty sepse unë mendojë se gjithçka është në rregull përveç mungesës së stafit që është edhe shqetësim i joni. Sa i përket uniformës së mjekut janë personat kompetentë që duhet me përcjellë këtë çështje.

Resul Suma thekson:-vërejtje kam për drejtorin e shërbimeve publike për shkak se qytetarët kanë pasur ankesa sa i përket pastrimit të rrugëve që personalisht isha në fshatin Krivenik dhe rrugën e kanë pastruar bashkë fshatarët e jo kompania e kontraktuar prej komunës. Të çështja e çerdhes deri ku kanë mbërri punët pas problemeve të cilat kanë qenë.

Erblin Meliqi thekson:-lagjja Meliq nuk ka rrymë dhe pasi kemi bashkëpunim me KEDS-in për vitin 2025 është mirë të diskutohet kjo çështje për shkak se lagjja Meliq është përballur me këtë problem që tri vite edhe pse kërkesat kanë qenë të një pas njëshme prej administratorit të lagjes. Kërkoj nga Drejtoria për Shërbime Publike që të bënë rregullimin e rrugës së Vakëfit. z.Sherif Berisha potencojë që ka keq menaxhim në QKMF por z.Zaim Bela potencojë mendimin e tij për QKMF , mirëpo unë mënoj që shërbimet të cilat i jep QKMF-ja në Han të Elezit nuk besoj që i jep asnjë QKMF në Kosovë.

Arsim Dernjani thekson:-rrugët janë pastruar brenda mundësive që i ka kompania dhe në teren kam qenë, e rrugët janë pastruar edhe në Krivenik, Dimcë dhe fshatrat tjerë dhe lagjet e komunës .

Refet Kalisi thekson:- edhe muajin e kaluar kam parashtruar pyetje se a janë asetet e kompanisë të gatëshme për punë. Dy rrugë kanë qenë që kanë pasur borë dhe nuk janë pastruar por nuk e di gjendje e pajisjeve të kompanisë sepse ndoshta janë në defekt por është kohë dimri dhe ne duhet të jemi të përgatitur.

Xhevahir Dernjani thekson:- viti 2024 ka kaluar me realizim të projekteve duke u nisur prej rrugës “Egzodi99” , asfaltimi i rrugës te fabrika Sharrceme cila do të shërben për mos pengesat e lagjeve të cilat gravitojnë në atë teren . Te infrastruktura shkollore është punuar shumë duke u nisur prej shkollës në Han të Elezit, Paldenicë dhe Goranacë. Në festivalin mbar kombëtarë të cilin e kemi është mirë që të përgaditemi që të marrim pjesë edhe na si nikoqirë që të marrim pjesë në garë fituese. Me një afat shumë të shkurtë është bërë rregullimi i kanalizimit prej rrugës së shkronjave e deri te dhoma e pritjes në fshatin Paldenicë.

Hisni Luri thekson:- mund ta shikoni gjendjen e instalimit siç ka qenë i shtrirë në çerdhe dhe vazhdimisht ku ka pasur probleme tensionet mund të shkaktojnë edhe zjarre . Në bazë të atyre të cilët kanë ardhur me sanuar problemin kanë potencuar që edhe një defekt sa do i vogël ka mundur me djegë çerdhen , mirëpo tash është shtrirë kompletë sistemi dhe është më mirë se sa ka qenë për shkak se kabllon elektrike të cilën e kemi dërguar është për një lagje.

Kryesuesi thekson:- e kemi biseduar me kryetarin dhe është e nevojshme trotuari që është rregulluar por është mirë me vazhduar edhe ka pjesa e lagjes së Vlashëve.

Hnumshahe Dibrani thekson:-falënderoj drejtorin e shërbimeve publike për realizimin e kërkesës të cilën e kam pasur për çështjen e zebrave.

Sherif Berisha thekson:- rrymë ka por rrjeti shpërndarës është me defekte dhe është mirë me ju drejtuar institucioneve kompetente. Te çështja e QKMF-së e kam potencuar edhe më herët që ka keq menaxhim sepse kam kërkuar edhe me fjalë edhe me shkrim por nuk më janë përgjigjur për shkak se sendet janë konkrete dhe shihen. Te çerdhja mirë që është rregulluar por nuk e di kush a shkojë në përgjegjësi për këto të cilat i paraqiti drejtori.

Mehmet Ballazhi thekson:-është fundi i vitit dhe jam falënderues për bashkëpunimin që kemi pasur që herë jemi pajtuar e herë s'jemi pajtuar dhe prej vetë seancës së sotme shihet që dikush është i kënaq me shërbim , pra ajo që është shumë e rëndësishme është se secili ka qenë i lirë me menduar siç ai ka dashur me shprehur atë pra është demokraci dhe zhvillim i demokracisë. Ju uroj që viti 2025 të jetë më i begatshëm dhe të jemi më unik në të gjitha qëllimet për të mirën e qytetarëve që të kemi suksese edhe më të hovshme krahasuar me vitet që kanë kaluar dhe besoj që viti i ardhshëm do të jetë më i intensifikuar në zgjidhjen e problemeve të cilat i kanë si kërkesë qytetarët.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:03.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta





REPUBLIKA E KOSOVËS- REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr. 04/ *260* /2025

DATA :	13.01.2025
PËR :	KPF dhe Kuvend Komunal
PËRMES :	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës Hani i Elezit <i>M Ballazhi</i>
NGA :	Lindita Ballazhi <i>L Ballazhi</i> Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA :	Raporti financiar për periudhën janar-dhjetor 2024

Të nderuar,

Bazuar në Ligjin nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të dispozitave të nenit 45, paragrafët 45.2 dhe 45.4, si dhe Statutit të Komunës së Hanit të Elezit të nenit 51, paragrafi 51.5, gjeni të bashkangjitur raportin financiar për periudhën janar-dhjetor 2024.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr. 04/260/2025

RAPORTI FINANCIAR JANAR-DHJETOR 2024

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA



Hani i Elezit, Janar 2025

Përkufizimet

Bilancet - shumat e zotimeve të papritura, ndarjeve buxhetore të pa alokuara, alokimet e pa zotuar dhe çfarëdo të ardhurash të një shume më të madhe se sa shuma e shpenzimeve dhe zotimet e papritura të bartura nga viti fiskal paraprak;

Organizatat Buxhetore – të gjitha Ministrinë, Komunitet, Agjencitë dhe Institucionet, të cilat pranojnë ndarje buxhetore nga Fondi i Kosovës sipas këtij ligji;

Zotimet - shpenzimet e parashikuara, për të cilat urdhëresa për pagesë të zotimit është plotësuar në pajtim me Rregullat Financiare të Thesarit dhe të cilat janë regjistruar në SIMFK, pa marrë parasysh nëse i nënshtrohen apo jo ndonjë detyrimi ligjor;

Kategoritë e shpenzimeve - kategoritë “Pagat dhe Shtesat”, “Mallrat dhe Shërbimet”, “Shërbimet Komunale”, “Subvencionet dhe Transferet”, “Shpenzimet Kapitale” dhe “Rezervat”.

Viti fiskal - periudhën nga 1 Janari i një viti deri 31 dhjetor të vitit të njëjtë;

Alokimi i fondeve – shuma maksimale për zotime dhe shpenzime që mund të bëhet kundrejt ndarjeve specifike buxhetore, siç është përcaktuar me procedurat e parapara në nenin 34 të LMFP-së dhe të regjistruara në SIMFK;

Subvencionet – fondet e siguruar nga shteti për të ndihmuar kompanitë, personat juridik ose sektorët e veçantë të ekonomisë si për shembull bujqësia;

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve KASH– Është një dokument i prioritetëve të politikave të Qeverisë që ka për qëllim orientimin e ndarjes së mjeteve buxhetore gjatë procesit të ardhshëm buxhetor. Përkrah parashikueshmërinë në procesin e buxhetit duke siguruar se buxheti bazohet në parashikimin afatmesëm makroekonomik dhe fiskal (zakonisht në një periudhë 3 vjeçare);

Të hyrat vetanake të komunave - çfarëdo e hyre e parasë publike e cila është vlerësuar dhe mbledhur nga komunitet nga burimet e specifikuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108;

Burimet e financimit – grantet qeveritare (GQ), të hyrat vetanake (THV), të hyrat e dedikuara (THD), të hyrat nga AKP-ja dhe financimet nga huamarrja brenda deficitit buxhetor (FH);

Transferet - Çdo ndryshim i ndodhur brenda ndarjeve të aprovuara të paraqitura në tabelat 3.1, 3.1A, 3.1 B, 3.2, 3.2B, 4.1, dhe 4.2 nënkupton transferet që janë:

- ndryshimi i shumave të ndara në mes të organizatave buxhetore,
- ndryshimet që ndodhin mes nën-programeve të po të njëjtës organizatë buxhetore dhe
- ndryshimet e ndodhura mes secilës kategori të shpenzimeve të paraqitur në tabelën 3.1,3.1A, 3.1B, 3.2, 3.2B, 4.1, dhe 4.2.

Rialokimet - Çdo ndryshim i ndodhur në tabelën 3.2, 3.2B; dhe 4.2 në kategorinë e shpenzimeve kapitale brenda një nën-programi të një organizate buxhetore;

HYRJE

Raporti financiar për periudhën janar - dhjetor 2024, është përgatitur në bazë të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të dispozitave të nenit 45, paragrafët 45.2 dhe 45.4, si dhe Statutin e Komunës së Hanit të Elezit të nenit 51, paragrafi 5.

Ky raport përmban një përmbledhje të trendeve kryesore të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore përgjatë periudhës një vjeçare të vitit 2024. Raporti përmban analiza përmbledhëse të periudhës përkatëse, pasqyron të hyrat sipas drejtorive, sipas llojit të të hyrave si dhe krahasimet me periudhat paraprake dhe projeksionet buxhetore.

Qëllimi i këtij raporti është që të njoftojë Kryetarin, Bordin e drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendin Komunal, për realizimin e buxhetit komunal përfshirë buxhetin e secilës Drejtori – Program Buxhetor, duke filluar prej programeve të Administratës së Përgjithshme, Shëndetësisë Primare, Arsimit dhe Shkenca për periudhën Janar – Dhjetor 2024, duke përfshirë kategoritë buxhetore të pagave dhe shtesave, mallrat dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencionet dhe transferet si dhe investimet kapitale.

Realizimin i të hyrave vetanake komunale dhe strukturën e tyre sipas burimeve të tyre, në mënyrë analitike, të hyrat nga gjocat e trafikut dhe të gjykatave si dhe krahasimi i tyre në raport me të njëjtën periudhë Janar-Dhjetor të vitit 2024/2023.

Buxheti i Komunës për vitin 2024, nënkupton Buxhetin e aprovuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, respektivisht Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2024, për komunën Hani i Elezit, të aprovuar paraprakisht edhe nga Kuvendi Komunal dhe organet e tij.

Prezantimi i të dhënave në këtë mënyrë mundëson:

- Prezantimin e raportit financiar në formë transparente dhe të tërësishme,
- Një pasqyrë për të gjitha kategoritë buxhetore: paga dhe shtesa, mallra dhe shërbimet, shpenzimet komunale, subvencionet dhe transferet si dhe investimet kapitale,
- Mundësinë e krahasimit në mes fondit të planifikuar, të alokuar dhe të shpenzuar sipas kategorive,
- Shprehja në përqindje e shfrytëzimit të buxhetit në periudhën vjetore.

Të dhënat e poshtë shënuara, sa i përket shpenzimeve për gjithë kategoritë buxhetore si dhe regjistrimi i të hyrave, sipas klasifikimit ekonomik janë të harmonizuara me Departamentin e Thesarit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe raportet që dalin nga SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës.

1. BUXHETI KOMUNAL 2024

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2024 është në lartësi prej **3,349,278.00Euro**.

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa..... 2,075,272.00 €,
- Mallra dhe shërbime..... 524,500.00 €,
- Shpenzimet komunale 93,500.00 €,
- Subvencione dhe transfere... 113,000.00 €,
- Shpenzime kapitale 543,006.00 €,
- Totali i buxhetit.....3,349,278.00 €.

Ndërsa buxheti përfundimtar është **4,010,573.67 €**, ku në këtë shumë përfshihen:

1. Mjetet e ndara nga Grantet Qeveritare në shumë prej **3,140,771.42 €**,
2. Projektioni i Të Hyrave Vetanake në shumë prej **274,376.00 €**,
3. Bartja e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga vitet paraprake në shumë prej **133,029.70 €**,
4. Mjetet e mbetura nga Donacioni i Qeverisë Japoneze për projektin “Ndërtimi aneksit për këmbësor në urën e Seçishtës” në shumë prej **15,923.01 €**,
5. Donacioni nga Unioni Evropian për projektin dy vjeçar “A smart system for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenc River Basin” në shumë prej **446,359.86 €**,
6. Mjete të mbetura nga Grante të cilat janë bartur vit pas viti në vlerë prej **113.68 €**.

Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar - dhjetor 2024 është në shumë prej **3,583,676.94 €**.

1.1 NDARJA FILLESTARE DHE FINALE E BUXHETIT

Kategoritë ekonomike	Ndarjet Buxhetore Nr: 08/L-260	Bartja e Bilancit të pashpenzuar	49 - EU - Unioni Evropian	Grante të mbetura	59 - Qeveria Japoneze	Shtesa të Qeverisë	Total
Paga dhe shtesa	2,075,272.00					65,869.42	2,141,141.42
Mallra dhe shërbime	524,500.00	1,751.05	82,103.01	0.50	800.00		609,154.56
Shpenzime Komunale	93,500.00						93,500.00
Subvencione dhe transfere	113,000.00	3,327.58	256,467.48				372,795.06
Shpenzime Kapitale	543,006.00	127,951.07	107,789.37	113.18	15,123.01		793,982.63
Rezerva	-						-
Total	3,349,278.00	133,029.70	446,359.86	113.68	15,923.01	65,869.42	4,010,573.67

2. TË HYRAT VETANAKE

2.1 Të Hyrat Vetanake Komunale të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2024/2023

Përshkrimi	Projeksioni i të hyrave vetanake 2024	Realizimi 2024	Realizimi 2023	Ndryshimi 2024-2023	Krahasimi 2024/2023
Të hyrat direkte	274,376.00	246,158.10	358,141.65	-111,983.55	-31.27%

-Vërejtje: në këtë tabelë të hyrat e realizuara për vitet 2024 dhe 2023 janë pa gjobat e trafikut dhe gjykatave.

2.2 Të hyrat e rregullta, Gjobat e Gjykatave, Gjobat në trafik 2024/2023.

Përshkrimi	Realizimi 2024	Realizimi 2023	Ndryshimi 2024-2023
Të hyrat e rregullta	246,158.10	358,141.65	(111,983.55)
Gjobat nga Gjykatat	-	-	-
Gjobat e trafikut	68,845.00	63,443.50	5,401.50
Të hyrat nga Agjensioni Pyjor	2,122.56	287.67	1,834.89
Totali	317,125.66	421,872.82	(104,747.16)

2.3 Krahاسimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike 2024/2023

Nr	Kodi	Përshkrimi	Realizimi 2024	Realizimi 2023	Krahاسimi në euro 2024-2023
			2	3	4=2-3
1	50013	Certifikatat e lindjes	280.50	121.00	159.50
2	50014	Certifikatat e kurorëzimit	578.50	740.00	(161.50)
3	50015	Certifikatat e vdekjes	27.00	45.00	(18.00)
4	50016	Certifikata tjera ofiqarie	4,476.00	6,050.00	(1,574.00)
5	50017	Taksa për verifikimin e dok. të ndryshme	20.50	12.00	8.50
6	50019	Taksa administrative	355.00	243.50	111.50
I		Administrata e Përgjithshme	5,737.50	7,211.50	(1,474.00)
7	40110	Tatimi në pronë dhe në tokë	75,869.93	160,834.64	-84,964.71
8	50001	Taksë për regjistrim të automjeteve	22,673.00	21,471.00	1,202.00
II		Buxhet dhe Financa	98,542.93	182,305.64	-83,762.71
9	50212	Të hyrat nga reklamimet publike	7,169.70	13,209.70	-6,040.00
10	50208	Licenca për transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave	265	0	265.00
10	50290	Licenca tjera për afarizëm	0	415	-415.00
11	50019	Taksa tjera administrative	3,569.25	297.5	3,271.75
12	50107	Gjjobat tjera	0	50	-50.00
III		Shërbimet Publike	11,003.95	13,972.20	-2,968.25
13	50012	Ndërrim destinimi i tokës	241	775	-534
14	50405	Shfrytëzimi i pronës publike	615	615	0
15	50107	Gjjoba tjera	0	59.5	-59.5
IV		Bujqësia dhe Zhvillimi Rural	856.00	1,449.50	-593.5
16	50029	Të hyrat nga ushtrimi i veprimt. afariste	77,591.88	78,097.44	-505.56
17	50104	Gjjoba nga Inspektoriati	1,000.00	0	1,000.00
18	50205	Licenca për pranim teknik të lokalit	10	60	-50.00
V		Zhvillimi Ekonomik	78,601.88	78,157.44	444.44
19	50009	Taksa komunale për leje ndërtimi	10,835.75	25,834.88	-14,999.13
20	50010	Taksa komunale për demolim	0	10	-10.00
21	50011	Taksë për bartjen e pronësisë	5,830.00	6,440.00	-610.00
22	50019	Shërbime të ndryshme kadastrale	0	12,285.00	-12,285.00
23	50026	Taksë për legalizim të objekteve	306.09	626.23	-320.14
25	50405	Shfrytëzimi i pronës publike	3,360.40	4,912.96	-1,552.56
26	50413	Të hyrat nga shitja e pasurisë	0	2,777.00	-2,777.00
27	50107	Gjjobat nga inspektoriati	0	870	-870.00
29	50019	Taksa tjera administrative	7,972.30	0	7,972.30
VI		Urbanizimi dhe Kadastri	28,304.54	53,756.07	-25,451.53

30	50405	Shfrytëzimi i pronës publike	95.00	0	95.00
VII		Kultura, Rinia dhe Sportet	95.00	0.00	95.00
31	50409	Participimet në Arsim	14,170.00	11,990.00	2,180.00
VIII		Arsimi	14,170.00	11,990.00	2,180.00
32	50019	Taksa për shërbimet sociale	280	239	41
33		Certifikata mjekësore	105	0	105
34	50409	Participimet në shëndetësi	8,461.30	9,060.30	-599
IX		Shëndetësia dhe MS	8,846.30	9,299.30	-453
A		TË HYRAT DIREKTE	246,158.10	358,141.65	-111,983.55
36	50101	Të hyrat nga dënimet në trafik	68,845.00	63,443.50	5,401.50
37		Të hyrat nga Agjensioni Pyjor	2,122.56	287.67	1,834.89
38	50102	Të hyrat nga dënimet në gjykata		0	0.00
B		TË HYRAT INDIREKTE	70,967.56	63,731.17	7,236.39
		TOTALI I PËRGJITHSHËM (A + B)	317,125.66	358,141.65	-41,015.99

3. REALIZIMI I BUXHETIT

3.1 Shpenzimet sipas programeve (drejtoritë)

Programet(Drejtoritë)	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitalet	Totali i shpenzimeve
Totali	2,141,141.42	519,794.18	81,219.67	370,958.48	470,563.19	3,583,676.94
GRANTI QEVERITAR (10)	2,141,141.42	469,004.42	81,219.67	-	342,808.33	3,034,173.84
Zyra e Kryetarit	108,694.18	33,352.40	-	-	-	142,046.58
Administrata e Përgjithshme	96,473.18	75,463.69	45,480.60	-	7,888.80	225,306.27
Zyra e Kuvendit Komunal	128,990.94	14,797.90	-	-	-	143,788.84
Buxhet dhe Financa	62,662.93	3,000.00	-	-	-	65,662.93
Shërbime Publike dhe Emergjencia	83,240.02	99,171.47	-	-	35,330.30	217,741.79
Zyra lokale për Komunitete	600.14	500.00	-	-	-	1,100.14
Bujqësia dhe Pylltaria	13,117.75	1,947.00	-	-	-	15,064.75
Zhvllimi Ekonomik dhe Turizmi	26,923.64	9,499.00	-	-	-	36,422.64
Urbanizmi	69,838.75	14,944.53	-	-	234,669.00	319,452.28
Administrata e Shëndetësisë	12,969.78	500.00	-	-	-	13,469.78
Shërbimet e Shëndetësisë Primare	282,589.62	69,391.90	11,506.93	-	14,375.50	377,863.95
Shërbimet sociale	24,099.61	2,745.88	867.30	-	-	27,712.79
Kultura, Rinia dhe Sportet	29,567.29	10,168.20	4,000.00	-	-	43,735.49
Administrata e Arsimit	28,901.19	43,633.10	-	-	50,544.73	123,079.02
Arsimi Parafillor dhe Çerdhet	78,449.73	7,867.89	2,471.73	-	-	88,789.35
Arsimi Fillor	923,693.90	74,786.80	13,527.08	-	-	1,012,007.78
Arsimi i Mesëm	170,328.77	7,234.66	3,366.03	-	-	180,929.46
TË HYRAT VETANAKE--21	-	35,350.03	-	112,352.00	7,434.02	155,136.05
Zyra e Kryetarit	-	-	-	45,999.00	-	45,999.00
Administrata	-	10,000.00	-	-	-	10,000.00
Shërbime Publike dhe Emergjencia	-	4,978.99	-	15,000.00	-	19,978.99
Bujqësia	-	-	-	15,703.00	-	15,703.00
Zhvllimi Ekonomik dhe Turizmi	-	-	-	10,000.00	-	10,000.00
Urbanizmi	-	3,000.00	-	-	7,434.02	10,434.02
Shërbimet e Shëndetësisë Primare	-	5,000.00	-	-	-	5,000.00
Administrata e Arsimit	-	-	-	25,650.00	-	25,650.00
Arsimi Parafillor dhe Çerdhet	-	12,371.04	-	-	-	12,371.04
TE HYRAT E BARTURA-22	-	1,682.80	-	2,139.00	120,320.84	124,142.64
Zyra e Kryetarit	-	-	-	297.58	-	297.58

Shërbime Publike dhe Emergjencia	-	-	-	1,841.42	-	1,841.42
Urbanizmi	-	139.19	-	-	120,320.84	120,460.03
Shërbimet e Shëndetësisë Primare	-	1,543.61	-	-	-	1,543.61
49 - Unioni Evropian	-	13,756.93	-	256,467.48	-	270,224.41
Urbanizmi	-	13,756.93	-	256,467.48	-	270,224.41

3.2 RAPORTI I KONTROLLIT BUXHETOR JANAR-DHJETOR 2024 NGA SIMFK

13440 – Shërbime këshilldhënëse dhe profesionale – Shpenzimi në këtë kod ekonomik ka të bëjë me ekzekutimin e këtyre pagesave: 3,382.60 € për 4 Administratorët e Këshillave Lokal, pagesa prej 7,509.70 € për tre konsulentë të angazhuar për Fondet Ipa, pagesa prej 1,425.00 € për psikologun e angazhuar te Qendra për punë sociale, pagesa prej 750.00 € për vlerësuesin e një lënde në Gjykatë, pagesa prej 423.94 € për konsulent në Drejtorinë e Urbanizmit, pagesën e një konsulente për hartimin e PZHK-së në shumë prej 2,520.01 €, angazhim i një konsulenti për nevoja të DUKMM në shumë prej 857.12 €.

13445 – Shërbimet e veçanta – Konsulentë dhe kontraktorë individual – Shpenzimi nga ky kod ekonomik për periudhën janar-dhjetor 2024 është në shumë prej 285.10 € dhe ka të bëjë me pagesën e psikologes në Qendrën për punë sociale.

13450 – Shërbimet e shtypjes/printimit – Shpenzimi nga ky kod ekonomik është në shumë prej 1,557.00 € dhe ka të bëjë me printime të ndryshme: kartolina, çanta, fletushka, profile ekonomik për nevoja të Drejtorisë së DHET në shumë prej 997.00 € dhe pagesa prej foli me mbishkrim, mirënjohje, ftesa, kimika me mbishkrim në shumë prej 560.00 €.

13460 – Shërbime Kontraktuese tjera – Shpenzimi nga ky kod ekonomik për periudhën janar-dhjetor 2024 është në shumë prej 24,128.98 €, këtu përfshihen këto pagesa: shuma prej 9,380.27 € për Fondin e Kosovës për Eficientë të Energjisë, pagesa e një mirëmbajtëse për objektin shëndetësor në shumë prej 400.00 €, shuma prej 1,315.41€ për Shërbimin Spitalor Klinik i

Kosovës dhe 3,497.99 € për riparimin e shportave, ulëseve, salldimi dhe riparimi i mbrojtseve, pagesa prej 996.00 € për furnizim me shporta të reja nëpër qytet, pagesa prej 997.70 € për vendosjen e rrethojave të urës në Lagjen e Re, pagesa për Institutin e Mjekësisë së Punës në shumë prej 120.00 € për leximi i dozimetrave, pagesa prej 2,701.21 € për Trustin dhe ATK për punëtorët me kontratë në vepër, pagesa prej 1,986.40 € për hartim të projekteve: Ballkoni Panoramik dhe Parku i fshatit Gorancë pagesa prej 2,964.00 € për hartimin e projekteve: Asfaltimi i rrugës Ekzodi 99 – Hani i Elezit, Dizajnimi i hapësirave të Brendshme të Strukturave në Parkun “Isa Berisha” dhe Rregullimi i varrezave të qytetit në rrafshë – Hani i Elezit, pagesa për Agjensionin Kadastral për pajisjen e GPS shuma prej 400.00 €.

13470 – Shërbime Teknike - Nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar pagesa për shërbime të zërimit, inçizime të manifestimeve të ndryshme, shënimin e datave etj, në shumë prej 3,036.73 €, shuma prej 3,665.21 € për TV Festina për transmetimin live të Seancave të Kuvendit, 400.00 € pagesa për marrjen e shatorave me qera për Panairin Tradicional, pagesa për organizimin e Panairit të Sportit në shumë prej 1,180.00 €, pagesa prej 998.00 € për veshjen e murit me ivericë të bardhë të Shpia e Kulturës si dhe pagesa prej 82.60 € për KEDS për taksë të kyçjes, pagesa prej 2,413.33 € pagesa për Fondin e Kosovës për Efijencë të Energjisë, pagesa prej 780.00€ për mirëmbajtjen e GPS të automjeteve zyrtare, pagesa prej 3,700.00 € servisimi dhe kalibrimi i pajisjeve mjekësore, pagesa për inçizime të manifestimeve 2,855.00 €.

13480- Shpenzime për Anëtarësim – Nga ky kod ekonomik është ekzekutuar pagesa e anëtarësisë në Asociacionin e Komunave në shumë prej 1,410.45 € si dhe 990.00 € për AZHR Lindje si dhe 300.00 € për anëtarësimin në Organizatën ALDA.

13501 – Mobiljet - shpenzimi nga ky kod ekonomik për periudhën janar-dhjetor 2024 është në shumë prej 1,055.00 € dhe ka të bëjë me furnizimin me karrige për nevojat e Administratës.

13503 – Kompjuterët - shpenzimi nga ky kod ekonomik për periudhën janar-dhjetor 2024 është në shumë prej 7,313.95 € pajisja me laptop/kompjuterë për nevoja të Administratës Komunale dhe Sektori i Arsimit.

13505 – Makina fotokopjuese – multifunksionale - shpenzimi nga ky kod ekonomik për periudhën janar-dhjetor 2024 është në shumë prej 5,515.00 € dhe ka të bëjë me furnizimin me makina fotokopjuese për nevojat e Administratës Komunale.

13509 – Pajisjet e tjera - Nga ky kod ekonomik është ekzekutuar pagesa prej 976.00 € për blerjen e dy televizorave së bashku me pajisjet përcjellëse për nevojat e SHFMU “Kështjella e Diturisë”,

pagesa prej 915.00€ për kamera të sigurisë, HDD min.4TB, Konektor, DWR, servisim dhe programim i kamerave, pagesa prej 3,855.00 € për furnizim me klima për nevoja të Administratës dhe Sektorit të Shëndetësisë, 868.00 € furnizim me kositëse të barit dhe 995.00 € pagesa për pajisjen me kamera dhe pajisje përcjellëse për SHFMU “Ilaz Thaçi” si dhe 150.00 € pagesë me Avancë.

13610 – Furnizime për zyrë - nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar pagesa në shumë prej 33,052.29 € për furnizim me letër A4 për nevojat e Administratës Komunale dhe të Sektorit të Arsimit, furnizim me kapëse, folldera, markera, kimika, receta për barna, libreza për shkolla, dëftesa për klasë të ndryshme, diploma për nevoja të shkollave, libra me kurrikul, furnizim me pajisje të nevojshme për turnire të sportit, suvenire, mirënjohje të ndryshme, shirit me material sintetik, tonera për printera dhe fotokopje, furnizim me ujë të pijes për nevojat e Administratës, furnizim me lule dhe drunjë dekorativ etj.

13620 – Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) - te ky kod ekonomik janë përfshirë këto pagesa: ushqim dhe pije për nevojat e Çerdhes, dhe shërbimet e byfësë Komunale në vlerë prej 25,741.14 €.

13630 – Furnizime mjekësore - nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar këto pagesa, si vijon: 7,791.48 € për MADEKOS Shpk për gjilpëra, ampulla, shiringa, sisteme të infuzionit dhe tableta të ndryshme dhe Genius Kosova për furnizim me ujë të destiluar, reagensa, epruveta, material të laboratorit, në shumë prej 12,275.00 € dhe pagesa për PRO Medical për furnizim me material stomatologjik në shumë prej 2,119.80 €.

13640 – Furnizimet e pastrimit - nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar pagesa për furnizim me produkte të pastrimit për nevoja të Administratës Komunale, Sektori i Arsimit dhe Shëndetësisë në shumë prej 9,089.92 €.

13660 Akomodimi për mikpritje të delegacioneve të jashtme – pagesa nga ky kod ekonomik është në shumë prej 120.00 € dhe ka të bëjë me akomodimin e dy mysafirëve nga Turqija.

13760 – Drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje - Ka të bëjë me pagesën e furnizimit me dru për nevojat e të gjithë Institucioneve Publike në Komunë, në shumë prej 26,119.50 €.

13780- Derivate për automjete, gjeneratorë dhe makineri - Te ky kod ekonomik janë përfshirë pagesa për karburant për vetura të Administratës Komunale, Sektori Shëndetësisë, Zjarrëfiksat në vlerë prej 22,870.72 €.

13810 – Avancë (paradhënia) për para të imëta – ky kod përfshin pagesa të cilat janë nën 100 € dhe për të cilat nuk zhvillohet procedura të prokurimit por që ndodhin ad hoc.

13950 – Regjistrimi i automjeteve – Te ky kod ekonomik janë përfshirë pagesa për regjistrimin e automjeteve komunale në vlerë prej 1,260.00 €,

13951 – Sigurimi i automjeteve - Te ky kod ekonomik janë përfshirë pagesa për sigurimin e automjeteve komunale në vlerë prej 3,402.77 €,

14010 – Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve - Te ky kod ekonomik janë përfshirë pagesa për larjen, servisimin dhe riparimin e automjeteve komunale në vlerë prej 9,053.45 €,

14020 – Mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste - Nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar pagesa në shumë prej 8,631.20 € për furnizim me material për mirëmbajtjen e objekteve si psh: lopata alumini, kabllo të ndryshme, cilindra, brava për dyer, drita led, doreza për dritare, kablla vazhduese etj.

14023 – Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore - Nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar pagesa në shumë prej 16,450.15 € ndaj NPL “Pastrimi” për 4 mirëmbajtës të objekteve arsimore dhe 8,021.20.00 € për furnizim me lopata alumini, kabllo të ndryshme, cilindra, brava për dyer, drita led, doreza për dritare, kablla vazhduese dhe 828.80 € pagesa për riparimin e dyerve dhe dritareve SHFMU “Ilaz Thaçi” dhe pagesa prej 46.00 € nga Avanci.

14024 - Mirëmbajtja e ndërtesave shëndetësore - Nga ky kod ekonomik është ekzekutuar pagesa për mirëmbajtësen e Objektivit Shëndetësor, të angazhuar nga NPL “Pastrimi” në shumë prej 4,400.00 € dhe pagesa për furnizim të nevojshëm për mirëmbajtjen e objektivit në shumë prej 1,260.00€.

14030 – Mirëmbajtja e autorrugëve – Pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-dhjetor 2024 është në shumë prej 6,946.00 €.

14032 – Mirëmbajtja e autorrugëve lokale - Nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar pagesa në shumë prej 53,875.68 € ndaj NPL “Pastrimi” për mirëmbajtjen e rrugëve, varrezave, kositja e parqeve, trotuareve, 5,715.00 € ndaj Europlus për zhbllokimin e kanalizimeve, pagesa prej 11,066.99 € ndaj Toni Injineri për mirëmbajtjen e ndriçimit publik dhe pagesa prej 9,518.99 € për KROSA SHPK për shenjëzimin horizontal dhe vertikal të rrugëve.

14050 – Mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve - Te ky kod ekonomik janë përfshirë pagesa për servisimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve në Sektorin e Shëndetësisë në shumë prej 3,200.00 €,

14130 – Qiraja – Pajisjet - Te ky kod ekonomik përfshihet pjesa e fundit e pagesës së makinave fotokopjuese të cilat kanë qënë me qira,

14160 – Qiraja për automjete - Nga ky kod ekonomik është ekzekutuar pagesa për automjetin me qira në Sektorin e Shëndetësisë në shumë prej 205.81 €.

14220 – Botimet e publikimeve - pagesa nga ky kod ekonomik ka të bëjë me blerjen e 33 ekzemplarëve të librave Fenikset e Lirisë, në shumë prej 495.00 €.

14310 – Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit - Pagesa nga ky kod ekonomik për periudhën janar-dhjetor 2024 është në shumë prej 24,135.27 €. Këtu përfshihen këto pagesa: drekë për anëtarët e Shoqatës Handikos, drekë për grupin teknik nga Rajoni i Gjilanit dhe Ferizajit për menaxhimin e integruar të mbeturinave, darkë me rastin e shfaqes teatrore “Tush & Shit”, pije për pjesëmarrës në homazhe të varrezat e dëshmorëve për shënimin e datave të ndryshme, darkë për ish anëtarët e klubit të mundjes “Sharri”, drekë zyrtare për mysafirë nga Maqedonia Veriore, darka e fundvitit për klubin futbollistik “Sharri”, drekë për përfaqësuesit e projektit për vendosjen e paneleve solare, Dreka me Komandën Rajonale të LTM Polish KFOR të cilët dhuruan Smart Tv dhe defibrilatorë dhe mjete tjera në çerdhe, drekë për pjesëmarrësit për aktivitetin “Libri i hapur” me temën “Të gjithë bashkë kundër urrejtjes” me grupin BIRD BOX – Qendra e Kompetencës – Ferizaj, drekë zyrtare për organizatën TOKA, drekë zyrtare për mysafirë të Kryetarit nga Shqipëria, drekë zyrtare për përfaqësues të KLGI-së, drekë zyrtare për përfaqësues nga Agjensioni për Informim dhe Privatësi, drekë zyrtare të projektit AQH, drekë zyrtare për delegacionin nga Komanda e Rajonit Perëndim të KFOR-it, drekë zyrtare me përfaqësuesit e Poliklinika “Pleura” pas nënshkrimit të marrëveshjes për ofrimin e shërbimeve me 30% zbritje, drekë me anëtarët e komisionit shtetëror për konfiskimin e mallrave, drekë për zyrtarët komunal për mbrojtjen e mjedisit dhe me përfaqësuesit e Agjencionit për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës, drekë për mysafirë, poetë, shkrimtarë dhe historian me rastin e vizitës tek Monumenti i “Ekzodi – Bllaca 99”, drekë me përfaqësuesit e Shoqata e Pensionerëve të TMK-FSK dhe Simpatizantëve ELITA të cilët i trajnuan stafin teknik të shkollave për përdorimin e bombolave kundër zjarrit, drekë me përfaqësues të Institutit për Qeverisje Lokale me të cilët u diskutua lidhur me bashkëpunimet në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Dreka me delegacionin e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë për lidhjen e Marrëveshjes së Bashkëpunimit, drekë për vullnetarët e aksionit të pastrimit dhe mbjelljes së drunjëve dekorativë, drekë me përfaqësues të Drejtorisë Rajonale për Rajonin e Ferizajit të Shërbimit Sprovues të Kosovës, drekë për përfaqësues të Caritasit Zviceran pas inaugurimit të projektit mjedisor në SHML “Dardania”, drekë për regjistruesit dhe mbikqyrësit e Regjistrimit të Popullsisë, drekë për mysafirë të Kryetarit nga Komuna e Çairit, drekë për përfaqësuesit e ASK dhe mbikqyrësit e Regjistrimit të Popullsisë nga komuna, drekë për mysafirë të Kryetarit nga Likova për bashkëpunim ndërkomunal, drekë për delegacion nga KFOR Italian dhe Polak, ushqim dhe pije për

përfaqes nga Kolegji AAB dhe profesionistë të fushës së arsimit pas takimit lidhur me mundësinë e bashkëpunimit me institucione, ushqim dhe pije për mysafirë të Kryetarit nga Shqipëria lidhur me diskutimet për Festivalin Folklorik Mbarëkombëtar Hani i Elezit 2024, drekë për përfaqësues të CNVP-së me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, drekë për komisionin shtetëror dhe komisionin komunal për vlerësimin e dëmeve pas konsultave me komisionin komunal përgjatë disa takimeve të mbajtura në Komunë, drekë për donatorët e Humanity First me rastin e përurimit të dhomës për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, drekë me përfaqësues nga OSBE dhe komisionin për hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027, ushqim dhe pije për poetët dhe vullnetarët e orës poetike dhe pikturës në kuadër të Javës Kulturore 2024, drekë për mysafirët nga Prizreni dhe Shqipëria me rastin e pjesëmarrjes në aktivitetet kulturore me rastin e 11 Qershorit - Ditës së Çlirimit dhe nata e tretë e Festivalit, Drekë për motoristët e MK Veteranët e zones Operative të Nerodimes të UÇK-së me rastin e vizitës së tyre me 12 Qershor – Dita e Çlirimit të Kosovës, drekë për gazetarët e RTV21 me rastin e marrjes së kronikave në fushën e shëndetësisë, bujqësisë, bletarisë dhe kulinarisë, drekë për delegacionin e Komunës së Likovës me rastin e vizitës së tyre në Han të Elezit, drekë për KFOR Italian dhe bashkëpunëtorët e tjerë me rastin e dhurimit të pajisjeve për Njësinë Profesionale të Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit në Komunën e Hanit të Elezit, drekë me organizatorët e Festivalit Ndërkombëtar “N’Karadak krisin tupanat” pas diskutimeve për realizimin e këtij Festivali në Han të Elezit me datën 30 Korrik 2024, drekë për KF “Sharri” U-14 për këshillin drejtues dhe lojtarët pas turneut të fituar në Shtutgart të Gjermanisë, drekë për përfaqësues dhe bashkëpunëtorët për aplikim në IPA Fonde, darkë për anëtarët e shoqërive kulturore dhe ansambleve pjesëmarrëse në Festivalin Ndërkombëtar “N’Karadak krisin tupanat”, drekë për përfaqësues të organizatës TOKA, drekë me përfaqësuesit e eShkollorit pas dakordimit të ofrimit të shërbimeve falas të platformës eShkollori për shkollat e Hanit të Elezit.

14410 – Vendime Gjyqësore - Nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar pagesa përmbarimore nga Sektori i Arsimit, në shumë prej 39,010.75 €.

4.2 KATEGORIA SHPENZIME KOMUNALE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

3	Shpenzimet komunale	Shpenzimi 2024	Shpenzimi 2023	Krahasimi 2024-2023	Krahasimi në %
13210	Energjia Elektrike	53,839.34	74,795.90	-20,956.56	-28.02
13220	Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit	4,783.44	-	4,783.44	#DIV/0!
13230	Mbeturinat	14,504.34	12,667.50	1,836.84	14.50
13250	Telefonia fikse	1,389.62	1,334.16	55.46	4.16
13260	Pagesat - Vendime Gjyqësore	6,702.93	-	6,702.93	#DIV/0!
	Totali për shpenzime komunale	81,219.67	88,797.56	-7,577.89	-8.53

13210 – Energjia Elektrike – Ky kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e energjisë elektrike për Administratën Komunale, Sektori i Arsimit, Sektori i Shëndetësisë dhe Zjarrëfiksat në shumë prej 53,839.34 €.

13220 - Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit – Nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar pagesa për Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit për Administratën Komunale, Sektori i Arsimit, Sektori i Shëndetësisë dhe Zjarrëfiksat në shumë prej 4,783.44 €.

13230 – Mbeturinat - Ky kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e mbeturinave për Administratën Komunale, Sektori i Arsimit, Sektori i Shëndetësisë dhe Zjarrëfiksat në shumë prej 14,504.34 €.

13250 – Telefonia fikse - Ky kod ekonomik ka të bëjë me pagesën e telefonisë fikse për Administratën Komunale dhe Sektori i Shëndetësisë në shumë prej 1,389.62 €.

13260 – Vendime Gjyqësore - Ky kod ekonomik ka të bëjë me pagesa përmbarimore të Sektorit të Arsimit në shumë prej 6,702.93 €.

4.3 KATEGORIA SUBVENCIONE DHE TRANSFERE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

4	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimi 2024	Shpenzimi 2023	Krahasimi 2024-2023	Krahasimi në %
21200	Subvencione për entitete jo-publike	50,583.00	32,020.00	18,563.00	57.97
22100	Transfere për qeveri tjera	256,467.48	-	256,467.48	#DIV/0!
22200	Transferet sociale për individë	999.00	54,435.42	-53,436.42	-98.16
22202	Transfere për përfitues individual tjerë	48,309.00		48,309.00	#DIV/0!
22300	Pagesa për vendime gjyqësore	14,600.00	500.00	14,100.00	2,820.00
	Totali në subvencione dhe transfere	370,958.48	86,955.42	284,003.06	326.61

SQARIME:

21200 – Subvencione për entitete jo publike – Nga ky kod ekonomik janë ekzekutuar 500.00 € për Shoqatën e parandalimit dhe largimit të rinisë, shuma prej 10,380.00 për Bashkësinë Islame për shpenzimet e varrimit, pagesa në shumë prej 4,500.00 € për Banjën e Kllokotit për rehabilitimin e familjeve të dëshmorëve, pagesa prej 25,000.00 € për mbështetjen e klubeve sportive dhe kulturore si dhe pagesa prej 500.00 € ndaj Qendrës për mbrojtjen e grave, pagesa për subvencionimin e fermerëve me pogaçe për bletarët dhe pajisje për fermerët në shumë prej 9,703.00 €.

22100 - Transfere për qeveri tjera – Nga ky kod ekonomik është bërë transferi i shumës prej 256,467.48 € në partnerin përfitues të IPA Fondeve nga Maqedonia Veriore – Protection and Rescue Directorate.

22200 – Transfere sociale për individë – Pagesa nga ky kod ekonomik ka të bëjë me subvencionimin e një libri, në shumë prej 999.00 €.

22202 – Transfere për përfitues individual tjerë – Nga ky kod ekonomik është ekzekutuar një pagesë prej 500.00 € për shërim jasht vendit, përfitues tjerë me nga 100.00 € për pagesa të lehonisë, pagesa e bursave të studentëve në shumë prej 19,850.00 €, subvencionimi i start-up bizneseve në shumë prej 8,937.00 €, pagesa prej 6,000.00 ndaj Islamic Relief për Marrëveshjen e Mirëkuptimit me Drejtorinë e Bujqësisë për subvencionimin e Bujqëve, mbështetjen e një qytetari për subvencionimin e librit “Resurset natyrore e pellgut të Lepencit” në shumë prej 500.00 €.

4.4 KATEGORIA SHPENZIME KAPITALE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

5	Investimet kapitale	Shpenzimi 2024	Shpenzimi 2023	Krahasimi 2024-2023	Krahasimi në %
31120	Ndërtesat e administratës afariste		58,467.00	-58,467.00	-100.00
31121	Ndërtesat arsimore	50,544.73	117,870.62	-67,325.89	-57.12
31122	Ndërtesat shëndetësore	14,375.50	31,670.44	-17,294.94	-54.61
31123	Objekte kulturore		-	0.00	#DIV/0!
31124	Objekte sportive		-	0.00	#DIV/0!
31230	Ndërtimi i rrugëve lokale	296,933.18	179,423.32	117,509.86	65.49
31240	Trotuare		23,090.00	-23,090.00	-100.00
31250	Rrjetet e kanalizimit	53,859.00	116,294.02	-62,435.02	-53.69
31260	Rrjetet e ujësjellësit	18,000.00	36,576.69	-18,576.69	-50.79
31270	Mirëmbajtja investive		77,565.64	-77,565.64	-100.00
31510	Furnizim me rrymë gjenerim & transmis.		-	0.00	#DIV/0!
31610	Paisje të teknologjisë Informative			0.00	#DIV/0!
31620	Mobilje			0.00	#DIV/0!
31660	Paisje tjera mjekësore			0.00	#DIV/0!
32100	Toka		2,540.00	-2,540.00	-100.00
32120	Parqet Nacionale		174,585.52	-174,585.52	-100.00
31690	Paisje tjera	7,888.80	-	7,888.80	#DIV/0!
33200	Transfere Kapitale-Entitete Jopublike			0.00	#DIV/0!
31701	Kamionë		0.40	-0.40	
31702	Xhip dhe kombibus		-	0.00	#DIV/0!
34000	Pagesa-vendime gjyqësore	28,961.98	-	28,961.98	#DIV/0!
	Totali për investime kapitale	470,563.19	818,083.65	(347,520.46)	(42.48)
	Totali për të gjitha kategoritë e shpenzimeve	3,583,676.94	3,453,882.26	129,794.68	3.76

5. FINANCIMI I INVESTIMEVE KAPITALE PËR VITIN 2024

Nr	Kodi	Programi/përshkrimi	Shpenzimi Janar-Dhjetor 2024
		SHPENZIMET KAPITALE TOTALE	470,563.19
	163	Administrata dhe Personeli	7,888.80
	16335	Administrata	7,888.80
1	55042	Vendosja e ashensorit në objektin e Komunës	7,888.80
	180	Shërbimet publike dhe emergjenca	35,330.30
	18444	Parandalimi dhe inspektimi i zjarreve	35,330.30
2	55033	Ndriçimi publik në fshatrat: Pustenik, Dimcë, Gorancë, Krivenik, Seçishtë, Rezhancë, Paldenicë, Dermjak	7,358.60
3	55035	Riparimi i rrugëve dhe trotuareve në Han të Elezit dhe në fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Rezhancë, Krivenik	9,971.70
4	55080	Shtimi i kapaciteteve të ujit në Lagjen e Re dhe në Han të Elezit	18,000.00
	660	Planifikim urban dhe mjedisi	362,423.86
	66480	Planifikimi urban dhe inspeksioni	362,423.86
5	47270	Asfaltimi i rrugës Gorancë-Krivenik	27,790.78
6	51576	Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik	69,998.57
7	51581	Rregullimi i kanalizimeve në Han të Elezit në Rr. Isa Berisha dhe zonat rurale në fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Krivenik, Dimcë	53,859.00
8	52894	Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Lagjen e Re dhe në fshatrat: Paldenicë, Dermjak, Pustenik, Seçishtë, Gorancë, Krivenik, Dimcë	37,271.59
9	53484	Ndërtimi (Rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Paldenicë, Pustenik, Seçishtë, Gorancë, Dimcë, Krivenik	17,275.72
10	55037	Asfaltimi i rrugës Ekzodi 99 - Hani i Elezit	17,516.00
11	51589	Rregullimi i prrockave dhe i kanalizimeve atmosferike në fshatrat: Paldenicë, Rezhancë dhe Seçishtë	1,171.20
12	55047	Zgjerimi i rrugës "Adem Jashari" 11 Qershori	9,679.50
13	55048	Asfaltimi i rrugës "Nehat Curri", lagja Curri - Dromjak	98,327.00
14	55050	Ndërtimi i rrugës Nënberg në fshatin Seçishtë	29,534.50
	730	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	14,375.50
	75050	Shërbimet e shëndetësisë primare	14,375.50
15	90629	Rregullimi i infrastrukturës së QKMF-së	14,375.50
	920	Arsimi dhe shkenca	50,544.73
	92175	Administrata	50,544.73
16	53774	Rregullimi i infrastrukturës shkollore në SHML - Dardania, SHFMU - Ilaz Thaçi, SHFMU - Kështjella e Diturisë dhe SHMFU - Veli Ballazhi	50,544.73



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit

DATA:	06.01.2025
PËR:	Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin e Komunës
KOPJE:	Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit z. Mehmet Ballazhi <i>M. Ballazhi</i>
NGA:	Drejtoreshë e Administratës së Përgjithshme znjsh. Natyra Kalisi <i>N. Kalisi</i>
LËNDA:	Shkresë Përcjellëse: Plani i punës së Këshillave të Fshatrave për vitin 2025.

Të nderuar,

Me anë të kësaj shkrese, të bashkangjitur gjeni Planin e Punës së Këshillave të Fshatrave të Hanit të Elezit për vitin 2025.

PLANI I PUNËS SË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE PËR VITIN 2025

SHKURT

01

1. Përgaditja e raportit të punës për vitin 2024.
2. Diskutim mbi sfidat dhe problemet në Këshillat Lokal.
3. Të ndryshme.

PRILL

02

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Siguria në komunitet.
3. Të ndryshme.

MAJ

03

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Fuqizimi i grave dhe grupeve të marginalizuara.
3. Diskutim mbi sfidat dhe problemet në Këshillat Lokal.
4. Të ndryshme

GUSHT

04

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Fillimi i vitit shkollor dhe çështjet arsimore.
3. Diskutim mbi planifikimin e buxhetit për vitin 2026.
4. Të ndryshme.

SHTATOR

05

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Takimet buxhetore.
3. Diskutim mbi sfidat dhe problemet në Këshillat Lokal.
4. Të ndryshme.

TETOR

06

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti për vitin 2025 dhe vlerësimi i punës.
3. Të ndryshme



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo

Komuna - Municipality

Hani i Elezit



02/Nr. 238 /2025

DATA:	09.01.2025
PËR:	Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin e Komunës
PËRMES:	Kryetarit të Komunës z.Mehmet Ballazhi
NGA:	Vjosa Rogaqi Zyrtare për Barazi Gjinore
LËNDA:	Raporti i Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore për vitin 2024.

Me anë të kësaj shkrese ua përcjellim Raporti i Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore për vitin 2024.

Me respekt

Raporti Vjetor i Plani Lokal i Veprimt për Barazi Gjinore

◆ Zyra për Barazi Gjinore

-Në kuadër të aktiviteteve për nder të "16 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës" është realizuar Turneu në Volejboll me stafin e gjinisë femërore me klubin e volejbollit të femrave Sharri, ku pjesmarrëse ishin 6 femra nga Komuna.

-Kryetari i komunës organizon një takim me drejtoreshat, zyrtaret komunale dhe praktikantet në institucionin e komunës, të cilave ju shpreh mirënjohje për punën dhe angazhimin e tyre për avancimin e pozitës së gruas në shoqëri, duke u bërë model shembullor për të gjitha vajzat dhe gratë e tjera.

Zëri i grave në Hanin e Elezit dëgjohet fuqishëm gjatë këtij mandati qeverisës, ku edhe jemi komuna e parë që arrin ta çojë në rreth 60% përfaqësimin e gruas në udhëheqje të drejtorive, përqindja më e lartë deri më tani në Kosovë.

-Gjatë viti Janar- Dhjetor 2024 janë subvencionuar 97 fëmijë të posalindur, në shumë prej 100€.

- Në bashkëpunim me NDI Kosovo kemi zhvilluar debatin mbi politikat lokale me temë "Fuqizimi ekonomik i gruas dhe rinisë në Han të Elezit".

Diskutimi i dialogut ka për qëllim të eksploroj situatën e deri tanishme dhe hapat e më tutjeshëm për fuqizimin e rinisë dhe grave në komunën tonë, një çështje që ka një rëndësi të madhe për zhvillimin e qëndrueshëm dhe prosperitetin e komunitetit tonë. Së bashku mund të ndërtojmë një Han të Elezit më të fortë, më të drejtë dhe më të qëndrueshëm. Fuqizimi i grave dhe të rinjve është një hap i domosdoshëm drejt këtij qëllimi!

-Takim (online) njoftues me përfaqësuesen e angazhimin e konsulentëve nga projekti 'GEF' i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga zyra e UNWOMEN në Kosovë.

- Drejtoria e shëndetësisë fushatën për muajin "Rozë", për ndërgjegjësimin mbi rrezikun e kancerit të gjirit me moton "LUFTO ME GUXIM" ku përkrahëse ka qenë dhe ZBGJ.

-Aktivitet tjetër dhe shumë i rëndësishëm ky gjatë muajit rozë edhe prania e mamografis mobile nga Ministria e Shëndetësisë, e mundësuar nga kërkesa e drejtoreshës së shëndetësisë së komunës së Hanit të Elezit.

-Shfaqja "Fustani rozë" ishte aktivitet gjatë muajit tetor, ku tregon historinë e një vajze të re dhe betejën e saj me sëmundjen e kancerit të gjirit.

-Trajnim me temën "Integrimi Gjinator" dhe vlersimi i ndikimit gjinator, i organizuar nga zyra e barazise gjinore në mbështetje të UN Women Kosovë në kuadër të projektit "Gender Equality Facility" ku morën pjesë gjithësesj njëmbëdhjetë zyrtarë komunal, ku nga këto 5 femra dhe 6 meshkuj.

-Hapja e fushatës "16 Ditët e Aktivizimit" kundër dhunës me bazë gjinore, në kuadër të këtij plani janë realizuar aktivitete të ndryshme si shenjë e sensibilizimit dhe luftimit të dhunës nga grave dhe vajzave.

-Si pjesë e fushatës "16 Ditët e Aktivizmit" kundër dhunës me bazë gjinore ka qenë edhe shfaqja teatrale "Monologjet e Vrrara" ku teme e kësaj ka qenë grat/vajzat e vrara.

-Ligjëratë me psikologe për fushatë "16 Ditët e Aktivizmit" ku të pranishëm ishin 28 pjesmarrës, në mesin e tyre 8 burra dhe 20 gra.

-Ndarja e materialeve ushqyes për bletë/pogaçe për vitin 2024, ku në mesin e 38 përfituesve dy (2) ishin gra që kanë përfituar.

-Gjatë vitit 2024 takime me KKSBN kemi mbajtur 6 mbledhje të rregullta dhe një mbledhje të jashtëzakonshme me rastin e rënies së breshërit, ku janë diskutuar problemet, shqetësimet dhe përmirësimi i gjendjes për qytetarët e komunës së Hanit të Elezit.

-Trajnim me temën "Buxhetimi gjinator" i organizuar nga zyra e barazise gjinore në mbështetje të UN Women Kosovë në kuadër të projektit "Gender Equality Facility" ku morën pjesë gjithëses 16 pjesmarrës në mesin e tyre, 11 gra dhe 5 burra.

◆Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizëm

-Subvencionimi me mjete monetare i bizneseve në pronësi të grave/ të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, janë mbështetur bizneset e reja ku përparësi në aplikim kanë pasur gratë dhe vajzat, ku në 5 përfitues, 2 prej tyre kanë qenë gra dhe vajza.

-Lirimi nga taksat komunale i bizneseve të regjistruara në pronësi të grave/të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, sipas Rregullores Komunale për Taksa dhe Tarifa, të gjitha bizneset e reja të regjistruara në Komunën e Hanit të Elezit do të lirohen nga taksa për Ushtrim të Veprimtarisë për 4 vite.

-Takime informuese me gratë dhe të reja në të gjithë diversitetin e tyre, për panairin vjetor lokal, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në këtë panair. Janë mbajtur disa takime me gratë që udhëheqin biznese por interesi për pjesëmarrje në panair ka qenë i vogël.

-Promovimi i rasteve të suksesit të profesionisteve dhe profesionistëve në të gjithë diversitetin e tyre, në panairin ndërkombëtar duke respektuar parimet e barazisë gjinore. 5 profesioniste (sipas treguesit) janë prezantuar në Panairin Ndërkombëtar duke përfshirë fusha të ndryshme.

-Sesione orientuese për gratë/ të rejtat e zonave rurale apo përfitueset e kategorive sociale mbi nevojën dhe kurset për aftësim profesiona, është organizuar 1 takim informues.



REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - OPSTINA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr. i Prot. 011/241
Nr. i Faq. 2 Data 13.01.25



Republika e Kosovës – Republic of Kosova

Komuna – Municipality

Hani i Elezit



DATA:	13.01.2025
PËR:	Kuvendin Komunal Hani i Elezit
NGA:	Mekanizmi kundër dhunës në familje në Han të Elezit
LËNDA:	Raport

Raporti i Planit të veprimit për parandalimin e dhunës në familje 2024-2026 i realizuar gjatë vitit 2024 sipas fushave, objektivave dhe aktiviteteve.

Gjatë vitit 2024 jemi munduar të realizohen fushat prioritare të strategjisë duke përmirësuar sistemin institucional për parandalimin dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për mbrojtje nga dhuna në familje si:

Në bashkëpunim me NDI Kosovo kemi zhvilluar debatin mbi politikat lokale me temë "Fuqizimi ekonomik i gruas dhe rinisë në Han të Elezit".

Diskutimi i dialogut ka për qëllim të eksploroj situatën e deri tanishme dhe hapat e më tutjeshëm për fuqizimin e rinisë dhe grave në komunën tonë, një çështje që ka një rëndësi të madhe për zhvillimin e qëndrueshëm dhe prosperitetin e komunitetit tonë.

Së bashku mund të ndërtojmë një Han të Elezit më të fortë, më të drejtë dhe më të qëndrueshëm. Fuqizimi i grave dhe të rinjëve është një hap i domosdoshëm drejt këtij qëllimi!

Trajnim me temën "Integrimi Gjinator" dhe vlersimi i ndikimit gjinator, i organizuar nga zyra e barazise gjinore në mbështetje të UN Women Kosovë ë kuadër të projektit "Gender Equality Facility" ku morën pjesë gjithësesj njëmbëdhjetë zyrtarë komunal, ku nga këto 5 femra dhe 6 meshkuj.

Hapja e fushatës "16 Ditët e Aktivizimit" kundër dhunës me bazë gjinore, në kuadër të këtij plani janë realizuar aktivitete të ndryshme si shenjë e sensibilizimit dhe luftimit të dhunës nga grave dhe vajzave.

Si pjesë e fushatës “16 Ditët e Aktivizmit” kundër dhunës me bazë gjinore ka qenë edhe shfaqja teatrale “Monologjet e Vrrara” ku teme e kësaj ka qenë grat/vajzat e vrara.

Ligjërata me psikologe për fushatë “16 Ditët e Aktivizmit” ku të pranishëm ishin 28 pjesmarrës, në mesin e tyre 8 burra dhe 20 gra.

Ndarja e materialeve ushqyes për bletë/pogaçe për vitin 2024, ku në mesin e 38 përfituesve dy (2) ishin gra që kanë përfituar.

Trajnim me temën “Buxheti gjinor” i organizuar nga zyra e barazise gjinore në mbështetje të UN Women Kosovë në kuadër të projektit “Gender Equality Facility” ku morën pjesë gjithëses 16 pjesmarrës në mesin e tyre, 11 gra dhe 5 burra.

Trajtimi i rasteve të dhunës në familje si këshillime profesionale, ofrimin e shërbimeve rehabilituese, mundësi riintegrimi etj.,,

Kemi pasur një bashkëpunim të mirë me mekanizmat tjerë për parandalim dhe trajtim të rasteve të dhunës në familje.

Kemi regjistruar çdo rast në sistemin e menaxhimit të rasteve të bazës së të dhënave të dhunës në familje.

Bashkëpunim shumë i mirë strehimoren për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve “Shtëpia Ime”

Këto janë aktivitetet e realizuara në përmbushjen e objektivave strategjike dhe shpresojmë se edhe vitin 2025 të kemi aktivitete të realizuara me qëllim zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit dhe njëkohësisht përmirëmin e gjendjes së vetëdijesimit për parandalim dhe ofrim të shërbimeve sa më cilësore për mbrojtjen nga dhuna në familje.

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - OPSTINA - MUNICIPALITY
HANI ELEZIT
Nr. Prot. 01/240
Nr. Faq. 2 Data 13.01.25



Republika e Kosovës – Republic of Kosova

Komuna – Municipality

Hani i Elezit



DATA:	13.01.2025
PËR:	Kuvendin Komunal Hani i Elezit
NGA:	Ekipi komunal për të drejtat e fëmijëve në Han të Elezit
LËNDA:	Raport



Raporti i Planit të veprimit për të drejtat e fëmijës në Han të Elezit 2024-2026 i realizuar gjatë vitit 2024 sipas fushave, objektivave dhe aktiviteteve.

Gjatë vitit 2024 jemi munduar të realizojmë aktivitete në ofrimin e shërbimeve më gjithëpërfshirës për fëmijët e komunës tonë si:

Janë mbajtur aktivitete kulturore dhe sportive që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve dhe njehërit zhvillimin e rekreacionit për fëmijë si psh. Organizimi i ditës së 1 Qershorit dhe vazhdimësia e saj deri më 11 qershor, pastaj aktivitete sportive si gara në sporte etj.,

Mbajtja e aktiviteteve kulturore duke promovuar artin.

Janë regjistruar nxënës duke respektuar rregulloret, dhe është bërë mirmbajtja e të dhenave për nxënës sipas modelit SMIA.

Është në funksion edhe ekipi për prandalimin e braktisjes së shkollës dhe mos regjistrimit.

Është bërë inspektimi i gjendjes sanitare në çdo fillim gjysëmvetori.

Është rregulluar dhoma për vlerëm të fëmijëve me nevoja të veqanta, janë identifikuar fëmijët me nevoja të veqanta dhe njehërit janë përditësuar të dhënat për fëmijë me nevoja të veqanta.

Trajnimet për mësimdhënës.

Vetëdijesimi i fëmijëve për ambientin.

Ofrimin e këshillimeve psiko-sociale për fëmijët në konflikt me ligjin.

Bashkëpunimi me mekanizmat tjerë në mbrojtjen e fëmijëve dhe trajtimin e fëmijëve delikuent.

Kemi mbajtur ligjerata në shkollë fillore me temën “të drejtat dhe përgjegjësitë e fëmijëve”

Mbajtja e fushatave vetëdijesuese për shëndetin dhe të ushqyerit e foshnjave, fëmijëve dhe adoleshentëve.

Mbajtja e ligjeratave në shkolla për edukimin shëndetësor.

Këto janë aktivitetet e realizuara në përmbushjen e objektivave strategjike dhe shpresojmë se edhe vitin 2025 të kemi aktivitete të realizuara me qëllim zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit dhe njëkohësisht përmirëmin e gjendjes së vetëdijesimit për parandalim dhe ofrim të shërbimeve sa më cilësore për mbrojtjen nga dhuna në familje.



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA HANI I ELEZIT

Nr. i Prot: 08/249

Data: 10.01.2025

INFORMATË MBI VEPRIMTARINË E SUBJEKTEVE AFARISTE PËR VITIN 2024

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZËM

HANI I ELEZIT
JANAR, 2025



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA – MUNICIPALITY OF
HANI I ELEZIT



DATA	10.01.2025
PËR	Komitetin për Politik e Financa dhe Kuvendin e Komunës
PËRMES	Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës <i>M Ballazhi</i>
NGA	Majlinda Kaloshi Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm
LËNDA	Informatë mbi veprimtarinë e subjekteve afariste për vitin 2024

Të nderuar,

Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim lëndën “Informatë mbi veprimtarinë e subjekteve afariste për vitin 2024”, e cila i adresohet Komitetit për Politik e Financa dhe Kuvendit të Komunës.

Drejtorja për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm, si përgjegjëse për bizneset që veprimtarinë e ushtrojnë në kuadër të komunës, prezanton këtë material i cili ka për qëllim ofrimin e një pasqyre të qartë për veprimtarinë ekonomike dhe rolin e saj në zhvillimin e përgjithshëm.

Me respekt!

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm është përgjegjëse për subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesore në territorin e Hanit të Elezit, mbajtjen e statistikave rreth tyre, krijimin e kushteve për zhvillim ekonomik lokal përmes strategjive të ndryshme sektoriale, promovim të komunës dhe kushte për zhvillim të qëndrueshëm duke qenë urë bashkëpunimi në mes ministrive, organizatave, donatorëve të huaj etj. dhe Komunës së Hanit të Elezit.

QENDRA PËR REGJISTRIM TË BIZNESEVE

Drejtoria në kuadër të saj ka edhe Qendrën për Regjistrim të Bizneseve e cila kryen të gjitha shërbimet sa i përket bizneseve lokale.

Sipas statistikave që Drejtoria ka, në Qendrën për Regjistrim të Qytetarëve që nga fillimet e saj e deri më tani janë të regjistruar 391 biznese, nga ku: 234 prej tyre i takojnë atyre Individuale (B.I), 156 biznese SHPK dhe 1 biznes SHA.

○ APLIKIME PËR BIZNESE TË REJA

Përshkrimi	Lloji	Numri	Totali 2024	Gjinia
Regjistrim biznesi	Biznese individuale / B.I	16	16 BI	06 / M
Regjistrim biznesi	Biznese Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara / SH.P.K	19	19 ShPK	29 / F

○ APLIKIME PËR SHUARJE TË BIZNESEVE

Përshkrimi	Lloji	Numri	Totali 2024	Gjinia
Shuarje të bizneseve	Biznese individuale / B.I	6	6 BI	4 F
Shuarje të bizneseve	Biznese Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara / SH.P.K	0	0 SHPK	2 M

○ APLIKIME PËR NDRYSHIME NË BIZNES


Përshkrimi i shërbimit	Totali
Kërkesë për informata	73
Kërkesë për ndryshimin e pronarëve /aksionarëve	4
Kërkesë për shtimin apo heqjen e aktivitetit	3
Kërkesë për ndryshim të adresës	4
Kërkesë për ndryshimin e drejtorit apo përfaqësuesit të autorizuar	3
Kërkesë për ndryshim të emrit tregtarë	0
Kërkesë për ndryshim të bordit	0
Kërkesë për shuarje të njësisë	3
Kërkesë për certifikatë dublikat	4

KATEGORIZIMI I SUBJEKTEVE AFARISTE

Në Han të Elezit, nga bizneset e rgjistruara dhe sipas të dhënave në ARBK kemi paraqitur një grafikë e cila paraqet një analizë sipas sektorëve ekonomik në përqindje. Këto kategori përfshijnë:


- Tregtinë (20%)
- Aktivitete shërbyese (16%)
- Transporti (18%)
- Ndërtimtaria (6%)
- Të tjera (40%)

Sipas këtij grafiku ilustruhet struktura e ekonomisë lokale të qytetit dhe prezantohet që sektorët kryesor janë të ndërlidhur me tregtië dhe shërbimet, ndërsa me anë të përqindjes ndërtimtaria figuron si sektor më pak i zhvilluar.



Grafiku 1. Bizneset sipas kategorizimit

Sipas të dhënave, del që përqindja më e madhe e bizneseve i takojnë kategorisë së bizneseve individuale BI rreth 65 %, ndërsa ato të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar ShPK rreth 34.8 %, të ndjekur më pas nga ato Shoqëri Aksionare SHA me 0.2 %.



Grafiku 2. Regjistrimi i bizneseve sipas llojit

SEKTORI I TAKSAVE PËR USHTRIM TË VEPRIMTARISË

Inspektimet Janar-Dhjetor 2024	40
Gjobat	02
Aktvendimet dhe shpërndarja e tyre tek subjektet aktive	220
Faturat e lëshuara gjatë viti 2024	50
Faturimi për vitin 2024	97,610.68
Inkasimi për vitin 2024	76,589.88

Përshkrimi	Periudha Kohore	Viti 2024	Viti 2023
TAKSË PËR USHTRIM TË VEPRIMTARISË	Janar-Dhjetor	77,591.88 €	72,250.94 €